

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Dhomës Kombëtare të Llogarive të Ukrainës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë

Dhoma Kombëtare e Llogarive të Ukrainës dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit i Republikës së Shqipërisë, referuar në vazhdim si “Palët Kontraktuese”,

- bazuar në parimet e respektit reciprok, mirëbesimit, barazisë dhe partneritetit të dyanshëm,
- udhëhequr nga qëllimet dhe principet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI),
- duke shprehur qëllimin e përbashkët për të zhvilluar efektivitetin e organeve të auditimit të jashtëm publik, kanë rënë dakort për sa vijon:

Neni 1

Palët Kontraktuese në përputhje me fushën e kompetencave të tyre përkatëse do të realizojnë bashkëpunimin në fushat e mëposhtme:

- Shkëmbimi i eksperiencës në metodat e auditimit dhe implementimin praktik të auditimit,
- Organizimi dhe mbarëvajtja e seminarëve, workshopeve dhe mbledhjeve të punës sa i përket tematikave të auditimit të jashtëm publik, duke përfshirë promovimin e trajnimit të stafit,
- Kryerja e auditimeve paralele në përputhje me programet e aprovuara të punës, bazuar në pëlqimin reciprok të palëve,
- Shkëmbimi i dokumenteve të legjislacionit kombëtar, informacionit profesional, materiale dhe metoda sa i përket auditimit.

Neni 2

Përgjatë bashkëpunimit nën frymën e kësaj marrëveshje, veçanërisht gjatë kryerjes së misionëve të auditimeve paralele, Palët Kontraktuese i përmbahen legjislacionit të tyre kombëtar, sidomos në situatat e mandateve respektive të auditimit, rregullave të ruajtjes së sekretit dhe parashikimeve të tjera për sa i përket konfidencialitetit, sipas legjislacionit të aplikueshëm. Rezultatet e auditimit do të publikohen vetëm bazuar në pëlqimin reciprok të palëve.

Neni 3

Në përputhje me fushën e bashkëpunimit për të cilën është rënë dakort në nenin 1, Palët Kontraktuese mund të shkëmbejnë delegacione, me qëllimin e përfundimit të njohurive praktike, njëkohësisht edhe të trajnimit të stafit.

Neni 4

Bazuar në parimin e reciprocitetit të palëve, në udhëtimet e nevojshme të bashkëpunimit, secila prej palëve do të mbulojë shpenzimet e tij/saj për udhëtimin, akomodimin, vaktet, interpretimin, vizën dhe sigurimin. Partneri pritës do të ofrojë pajisje teknike dhe dokumente të rëndësishme pa asnjë kosto.

Neni 5

Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me parashikimet, interpretimin dhe implementimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhen duke zhvilluar konsultime të dyanshme ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Neni 6

Parashikimet e bëra në këtë marrëveshje mund të ndryshohen apo amendohen, vetëm pas një marrëveshje të përbashkët mes Palëve Kontraktuese. Të gjitha ndryshimet dhe amendimet do të jenë pjesë integrale e kësaj marrëveshje dhe do të hartohen sipas Protokolleve të veçanta.

Neni 7

Kjo marrëveshje nuk do të dëmtojë të drejtat dhe angazhimet e Palëve Kontraktuese sa i përket marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në të cilat ata aderojnë, ose mund të aderojnë.


Neni 8

Marrëveshja e tanishme do të hyjë në fuqi ditën e firmosjes së saj nga palët. Secila nga palët mund të heqë dorë nga kjo marrëveshje, pa deklaruar asnjë arsye. Përfundimi do të bëhet në mënyrë të shkruar dhe do të hyjë në fuqi një muaj pas njoftimit të përfundimit.

Kiev _____ 2018, tekstet në gjuhët Ukrainase, Shqiptare dhe Angleze, janë të njëjta.


Në rast të ndonjë opinioni të ndryshëm përsa i përket parashikimeve të kësaj marrëveshje, do të prevalojë teksti në gjuhën angleze.

**Kryetari i Dhomës Kombëtare
të Llogarive të Ukrainës
Shqipërisë**



Valeriy Patskan

**Kryetari i Kontrollit të Lartë
të Shtetit të Republikës së**



Bujar Leskaj